



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë Vodafone Magyarország Távközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság nga shoqëria "ANTENNA HUNGÁRIA" Magyar Műsorszóró és Rádióhírközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e përfitimit të kontrollit të shoqërisë Vodafone Magyarország Távközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság nga shoqëria "ANTENNA HUNGÁRIA" Magyar Műsorszóró és Rádióhírközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

Referuar marrëveshjes,:

Pala Blerëse

– **"ANTENNA HUNGÁRIA" Magyar Műsorszóró és Rádióhírközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság**, është një shoqëri aksionare, e regjistruar sipas legjislacionit Hungarez, e cila e ushtron aktivitetin e saj në fushën e ofrimit të shërbimeve të programimit dhe transmetimit televiziv, transmetimit radiofonik, aktivitetet e telekomunikacionit me kablllo dhe pa tela, satelitor dhe aktivitete të tjera të telekomunikacionit në Hungari.

– **4iG Nyilvánosan Működő Részvénytársaság**, (4iG Nyrt) është një shoqëri aksionare/publike e kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit hungarez, me objekt veprimtarie: prodhim kompjutera dhe pajisje periferike, prodhim i makinerive dhe pajisjeve të zyrës (përveç kompjuterëve dhe pajisjeve periferike), montimi i makinerive dhe pajisjeve industriale, organizimi i projektit të ndërtimit të objekteve, përgatitja e sipërfaqes së ndërtimit, shërbimet e tregtisë me shumicë të kompjuterëve, njësive periferike dhe programeve kompjuterike, tregti me shumicë jo e specializuar, shërbimet e tregtisë me pakicë të kompjuterëve, njësive periferike dhe programeve kompjuterike, etj.

4iG Nyrt ka hyrë në tregun e telekomunikacionit në Shqipëri nëpërmjet marrëveshjes së përfitimit të kontrollit të shoqërive Altelecom SHA dhe One telecommunications SHA (sot One Albania SHA).

– **Corvinus Nemzetközi Befektetési Zártkörűen Működő Részvénytársaság**, është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit Hungarez, e cila zotërohet 100% nga shteti hungarez.

Pala shitëse: Vodafone Europe B.V., është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit Hollandez. Vodafone Europe B.V është një kompani holding, e cila operon në sektorin e telekomunikacionit celular.

Target: Vodafone Magyarország Távközlési Zártkörűen Működő Részvénytársaság, është një shoqëri aksionare, e regjistruar sipas legjislacionit të Hungarisë, e cila kryen veprimtari kryesore në shërbimet e komunikimit pa tela, shoqëruar me veprimtari të tjera si: shërbime të tjera të teknologjisë së informacionit, dhënia me qira dhe funksionimi i pasurive të paluajtshme në pronësi private, veprimtari kontabiliteti, auditimi dhe ekspertimi tatimor, marrja me qira e pajisjeve të zyrës (përfshirë kompjuterin) dhënia me qira e makinerive të tjera dhe aseteve të prekshme, Prodhimi i komponentëve elektronikë, etj.

Shoqëria Target nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.